



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 34 dt.08.05.1995

Këshilli Bashkiak i qytetit Tiranës, i mbledhur sot më dt.08.05.1995, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria Admin.Financës dhe Seksioni Financës

**VENDOSI**

1. Të miratojë realizimin e fondit prej 146.216.727 lekë nga vjelja e taksave në zbatim të ligjit Nr.7777, dt.22.12.1993.
2. Të miratojë përdorimin e të ardhurave prej 123.272.736 lekësh.
3. Të miratojë çeljen e fondeve nga të ardhurat e Bashkisë për vitin 1995 si më poshtë :
  - 19 milion lekë për vazhdimin e punimeve të tregut me shumicë në Qytetin e Nxënësve.
  - 5 milion lekë për ndërtimin e tregut në Kombinat dhe Laprakë (çelja të bëhet mbas 6M I-rë).
  - 500 mijë lekë për studimin në markatën e mishit në pazarin e ri.
  - 1 milion lekë për blerje mjete transporti

- 14.500 mijë lekë për Ndërmarrjen e Ndriçimit Publik për gjithë vitin 1995 çelja të bëhet tremujore.
- 8 milion lekë për llogarin e Bashkisë nga të cilat 3 milion lekë për financimin e aktiviteteve të ndryshme që do të bëhen gjatë vitit dhe 5 milion për investime.
- 1.725 mijë lekë për financimin e projektit për ndërtimin e ujësjellësit të Tiranës sipas dokumentave ekzistuese.
- 1 milion lekë për financimin e investimeve të D.D.D.
- Përdorimi i këtyre fondeve do të bëhet mbi bazën e kërkesave të VKM Nr.467, mbi prokurimin me fonde buxhetore.
- Çelja e fondeve të mësipërme do të bëhet gjatë vitit 1995 mbas arkëtimit të të ardhurave.
- Për ndjekjen e zbatimit e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Seksionet përkatëse.
- Të çelen fonde për pajisjen e Këshillit Bashkiak me mjete dhe pajisjet e nevojshme.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**BESNIK PETRELA**